

STATUTI DHE AKTI I THEMELIMIT

ANANTA sh.p.k

Sot, me date **07 shtator 2023** (dymije e njëzet e tre) ne Tirane unë Z. Arben Pirgu, shtetas shqiptar, lindur më 16.10.1957, në Tiranë me pasaportë nr. F71016109L, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në bazë të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008 " PËR TREGTARËT DHE SHOQËRITË TREGTARE" vendos të themeloj shoqërinë si më poshtë:

KAPITULLI I

EMRI I SHOQËRISË- SELIA- KOHËZGJATJA-OBJEKTI

Neni 1

Emri

- 1.1. Shoqëria do të quhet **Ananta shpk** . (Këtu e më poshtë "Shoqëria")
- 1.2. Shoqëria do të organizohet në formën e një shoqërie me përgjési të kufizuar në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë.
- 1.3. Shoqëria do të ketë vulën e saj zyrtare.

Neni 2

Selia

- 2.1. Selia e shoqërisë do të jetë tek rr B. ZH. DARK, Pallati 2 Shkalla 4, Kati 1, Tirane.


Neni 3

Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e Shoqërisë është e palimituar.

Neni 4

Objekti



4.1. Objekti i aktivitetit të shoqërisë është:

Zyrë e kembimit valutor

KAPITULLI II

KAPITALI THEMELTAR

NENI 5

Kapitali Themeltar

Kapitali themeltar i shoqërisë është 2.500.000 lekë (dy milion e peseqind mije lekë) i përbërë nga nje kuotë.

z. Arben Pirgu zotëron 100 % te kapital te shoqërisë ne vlere 2.500.000 lekë (dy milion e peseqind mije lekë lekë).

Kapitali mund te shtohet ose te pakesohet sipas vendimit te asamblese se ortakeve themelues. Kuota e Pjesmarresve ne kapital jane te gjitha te emruara dhe te pa ndashme. Cdo kuote i takon e drejta e nje vote.

NENI 6

Ortaku qe ka ndermend te shesi kuotat e tij teresisht, apo pjeserisht duhet me pare te njoftoje ortakun tjeter te shoqerise. Ortaku tjeter ka te drejten e blerjes se pare.Kete te drejta ortakut duhet ta ushtroje Brenda 30 Diteve nga dita e njoftimit.

Ne rastin e mos ushtrimit te se drejtes se blerjes se pare, ortakut qe do te shese kuotat duhet te njoftoje emerin e bleserit dhe kushtet, te cilat nuk duhet te jene me te favorshme se sa ato te afruara ortakut tjeter te shoqerise.

NENI 7

Kapitali i shoqërisë përbehet, nga kapitali fillestar plus shtesën e bere, mjetet e xhiros, pasuri te luajtshme ose te paluajtshme etj te nevojshme për ushtrimin e aktivitetit te shoqërisë.

NENI 8

Kuotat e kapitalit janë te pasqyruara dhe te regjistruara ne librat e llogarisë te shoqërisë.

NENI 9

Heqja dore e ortakut nga bashkëpunimi nuk e çliron ortakun e larguar nga detyrimet qe kane lindur para se ai te largohet. Po kështu ai fiton dhe te drejttat qe janë krijuar para largimit te tij .

NENI 10

Fitimet qe realizohen gjate veprimtarisë dhe qe konkretizohen me nxjerrjen e bilanceve periodike, ndahen midis ortakëve ne proporcion me përqindjen e kapitalit te investuar, por kurdoherë pasi të jenë shlyer detyrimet ligjore.

Kapitali i investuar nga ortakët nuk mund te zvogëlohet nen kufijtë e parashikuar ne ligj .

NENI 11

Shoqëria tregtare "Ananta" sh.p.k. është përdoruese dhe disponuese e pasurisë se saj. Ajo mund te blejë dhe te shfrytëzoje te drejta te tjera, material ose jo material, duke përfshire edhe te drejtën për shitjen e pasurive se vet tek te tjerët.

Ne Republikën e Shqipërisë Shoqëria tregtare Ananta sh.p.k. gezon te drejta sikundër çdo person tjetër juridik, shqiptar ose i huaj ne përputhje me legjislacioni ne fuqi.

NENI 12

Shoqëria tregtare "Ananta" sh.p.k. vepron ne regjimin e pronës private dhe merr përsipër te drejtat e detyrimet vetëm brenda kufirit te kapitalit te saj. Ortakët themelues te shoqërisë, mbartin rrezikun e veprimtarisë se shoqërisë, vetëm ne nivelin e kuotave te kapitalit te investuar ne te. Shoqëria nuk përgjigjet për detyrimet qe ortakët kane pasur para se ajo te krijohet.

KAPITULLI I III

DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I SHOQERISE

NENI 13

Kompetencat e ortakut

13.1 Ka të drejtë të administroj aktivitetin e shoqërisë, konform objektit të veprimtarisë se saj, duke përfshire edhe veprimtarinë prodhuese e tregtuese që Shoqëria mund te kryej, vlerat e saj intelektuale e ekonomike-financiare. Kane të drejtë të marrin dijeni për rezultatet ekonomiko financiare ne çdo faze te aktivitetit te saj. Kane te drejte te marrin pjese vete ose me ane te përfaqësueseve ne këtë aktivitet.

13.2 Kane te drejte te tërheqin te gjitha dokumentet kryesore te shoqerise per tre vjetet e fundit

13.3 Kane te drejte te heqin dore nga shoqeria dhe mund te shesin pjesen e kapitalit te tyre ne perputhje me kushtet qe i lejon statute dhe ligji.

13.4 Ortakët ne perputhje me statutin e aktin e themelimit dhe legjislacionin ne fuqi kane, te drejte qe ne te njejten kohe te jene ortakë edhe ne shoqeri te tjera.

13.5 Ortaket rezervojne te gjitha te drejtat sipas ligjit Tregtar.

NENI 14

Shoqeria do te drejtohet nga administratori i saj z. Arben Pirgu.

NENI 15

Administrimi i shoqërisë

15.1 Administratori ka te gjitha te drejtat dhe fuqite per drejtimin e zakonshëm te shoqërisë, me qellim qe te arrije objektivat e saj, përveç atyre qe ligji ia atribuon ortakeve.

15.2 Administratori përfaqëson shoqërinë ne mardhenie me te tretet si dhe para organeve te administratës dhe atyre gjyqjesore.

15.3. Administratori përgjigjet individualisht ndaj shoqërisë ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, për shkelje te statutit apo per deme te kryera gjate administrimit.Ortaku ka te drejte te ngrej padi ndaj administratorit.

15.4 Administratori emerohet dhe shkarkohen me vendim te ortakut, kan të drejtë të veproj, firmosi pranë çdo organi administrativ, banke të nivelit të dytë dhe ku të shikohet e arsyeshme për të ushtruar aktivitetin e shoqërisë.

15.5 Shoqeria administratohet te pakten 1(nje) dhe maksimumi 3(tre) administrator , te cilet qendrojne ne detyre deri ne revokimin apo doreheqjen per nje periudhe maksimale prej (5 vjetesh

15.6. Çdo administrator do te ketë te drejte për rimbussimin e shpenzimeve te bera prej tij per llogari te shoqërisë .

15.7 Kur administrator i shoqerise rezulton i sukseshem ne punen e tij dhe ne rezultatin financiar te kompanise atehere ortaket vendosin lidhur me shperblimin qe do ti jepet atij ne fund te vitit financiar .

NENI 16

Detyrat e Administratorit/ëve

Administratori i shoqërisë ka dhe këto detyra dhe te drejta.

- Te mirë administroje pasurine e shoqerise
- Te lidhe marveshje me te tretet Brenda objektit te veprimtarise se shoqerise dhe kompetencave te caktuara nga ortaket.
- Te zbatoje rregullat e brendeshme te shoqerise
- Te shperbleje demet qe l vijne shoqerise si pasoje e veprimeve apo mos veprimeve te tij.
- Te paguhet per punen e kryer ne baze te marveshjes se bere midis tij dhe ortakeve.

- Te marre te dhena e te beje propozime mbi gjithcka qe ai e quant e dobishme per shoqerine
- Te miratoje planet e llogarive ekonomike pas perpunimit te tyre dhe ti paraqese ato sipas rastit per miratimin perfundimntar nga ortakët
- Te behen prpozimet perkatese ortakut te vetem kur lind nevoja per ndryshime ne kapitalin themeltar te shoqerise.
- Te miratoje aktet normative qe percaktojne aportet ne gjirin e shoqerise duke perfshire kuadrin e personelin
- Te percaktoje strukturen e aparatit te shoqerise dhe te krijojne organe te tjera te domozdoshme per realizimin e objektivave te shoqerise.
- Ti propozoje ortakeve per krijimin e enjesive strukturave te ndryshme si filial, dege e e përfaqësi ne qytetet te tjera te vendit ose jashte shtetit.
- Te përgatise propozimin për pushimin e veprimtarisë se shoqërisë dhe t'ia paraqesë ortakut për miratim.Të përzgjedhë ekspertin kontabël dhe anëtare te komisionit te likuidimit si dhe te paraqes propozimet për miratim para ortakeve .
- Te siguroje zbatimin e përpikte te Vendimeve te Ortakeve.
- Te kryeje çdo detyre tjetër qe i ngarkohet nga ortaku i vetem i shoqerise.

NENI 17 EKSPERTI KONTABEL

17.1 Shoqëria cakton ekspert kontabël për çdo viti financiar. Caktimi i tyre e bënë administrator

17.2 Eksperti kontabël mban përgjegjësi per mirëmbajtjen e rregullt të gjithë dokumentacionit te shoqërisë

17.3 Ato përgjigjen për demet qe i vijnë shoqërisë nga mbajtja e pa rregullt e llogarive ose verifikimi i tyre i gabuar.

17.4 Eksperti kontabël i autorizuar mund te shkarkohet sipas mënyrës se parashikuar nga legjislacioni ne fuqi .

17.5 Nuk mund te ngarkohen me detyrën e ekspertit, themeluesit, administratorët, personat qe jane ne gjini e krushqi deri ne shkallen e katert. Po ashtu nuk mund te kryeje kete detyre pergjegjsat e syrave, filialeve e agjensive.

KREU III MARDHENIET E PUNES NENI 18

Marrëdhëniet e punës ne shoqëri rregullohen nëpërmjet kontratave te punës.Për çeshtjet qe kjo kontrate nuk l parashikon zbatohen dispozitat përkatëse te legjislacionit shqiptar ne fuqi.



NENI 19

Për çdo mos marrëveshje që mund të lind midis palëve dhe që nuk zgjidhet me mirëkuptim apo konsensus, organi kompetent për zgjidhjen e saj është Gjykata e rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 20

Sekreti i punës

Te gjithë të punësuarit në shoqëri janë të detyruar të ruajnë sekretin e punës së shoqërisë. Kjo detyrë vazhdon edhe pas largimit të tyre nga shoqëria.

KAPITULLI I IV

VITIT FINANCIAR, BILANCI VJETOR SHPERNDARJA E FITIMIT

NENI 21

Viti financiar

Viti financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor të çdo viti.

Përgjithësisht Viti I parë financiar përfshin kohën nga data e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe përfundon me 31 dhjetor të të një viti.

NENI 22

Inventari dhe llogarite vjetore.

Shoqëria do të mbajë një kontabilitet të rregullt të pasurisë dhe të veprimtarisë së saj në pajtim me kërkesat ligjore.

Në mbylljen e vitit financiar administratori harton inventarin e pasurisë në këtë datë dhe llogarite vjetore për vitin financiar.

NENI 23

Raportet vjetore

23.1 Në mbylljen e çdo viti financiar administratori dhe eksperti kontabël harton inventarët dhe llogarite vjetore në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi për kontabilitetin si dhe harton një raport me shkrim për ortaket.

23.2 Raporti pasqyron gjendjen e shoqërisë gjatë vitit financiar të kaluar, ndryshimet e parashikuara, veprimtaritë e rëndësishme etj.

23.3 Bilancet vjetore, inventari, raportet e administratorit dhe ekspertit kontabël të autorizuar (nëse është emëruar) miratohen nga ortaket sipas Ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare".

KAPITULLI V

MBYLLJA E SHOQERISE, LIKUJDIMI

NENI 26

Veprimtaria e shoqërisë mund të ndërpritet para afatit kur shoqëria nuk rezulton rentable gjatë dy vjetëve të fundit radhazi dhe kur për këtë vendos gjykata kompetente.

NENI 27

27.1 Menjëherë pas marrjes së vendimit për prishjen e shoqërisë, ortakët caktojnë një likuiditor, kompetencat e tij dhe mënyrën e likuidimit të shoqërisë, me dispozitat përkatëse të ligjit tregtar. Shoqëria gjatë likuidimit mban anash emërtimit dhe emrin "Shoqëri në Likuidim e siper".

27.2 Likuiditori i emëruar nga ortakët menjëherë sapo merr detyrën është i detyruar të publikojë bilancin e shoqërisë duke specifikuar aktivin dhe pasivin dhe t'ia vënë në dispozicion menjëherë ortakëve.

27.3 Me miratimin e likuidimit shoqëria i jep fund veprimtarisë.

NENI 28

Ortakët vendosin mbi rregulshmerinë e likuidimit, për të vendosur për bilancin e likuidimit dhe heqjen e mandatit të likuiditorit.

Ortakët mund të vendosin vetë realizimin e kësaj mbledhje, në rast se likuiditori nuk e kërkon. Mbledhja vendoset edhe nga gjykata mbi propozimin e Ortakëve ose të një mandatmbajtësi të caktuar prej tij.

NENI 29

Kur ortakët për shkakë të arsyeshme nuk vendosin për aktet e mësipërme, likuidatori dhe çdo person i interesuar mund të kërkojë nga Gjykata mbylljen e likuidimit.

Aktet e mbylljes dhe likuidimit e depozitimit të dokumentacionit në regjistrin tregtar Shoqëriac' regjistrohet prej tij.

DISPOZITET KALIMTARE

NENI 30

Dispozitat e fundit

30.1 Për të gjitha çështjet që nuk gjejnë rregullim në këtë Statut, aplikohen dispozitat e Ligjit Nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare"

30.2 Për efekt të interpretimit të këtij Statuti me Ligj Tregtar nenkuptohet Ligji nr 9901 datë 14.04.2008 "Për Shoqëritë Tregtare"

30.3 Pavlefshmëria eventuale të dispozitave të veçanta të Statutit nuk mund të cenojnë vlefshmërinë e tij.

NENI 31

Gjykata kompetente.

Gjykata kompetente per zgjidhjen e te gjitha mosmarveshjeve dhe intepretimin e Statutit te Shoqërisë është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tirane.

NENI 32

Hyrja ne fuqi

Ky Statut dhe Akt themelimi hyn ne fuqi dhe eshte i detyrueshem per zbatim ne momentin e firmosjes nga Ortaket.

ORTAKU DHE THEMELUES I SHOQERISE

" ANANTA " sh.p.k.

Z. ARBEN PIRGU

Arben Pirgu

